

Emertimi i shoqërisë dhe forma ligjore : " KID ZONE " sh.p.k

NIPT : L 11716007 K
Adresa e selisë : Rruga Nacionale Tirane-Elbasan ,
Farke ,Tirane

Data e krijimit : 12 Maj 2011

Nr. Regjistrimit tregtar : Nr

Veprimtaria kryesore : Tregtimi i mallrave me shumicë e pakice, Import-Eksport etj ,sipas
Objektit të veprimtarisë të përcaktuar në akt themelimit dhe statut

PASQYRAT FINANCIARE

(Në zbatim të SKK nr.2 dhe Ligjit Nr. 9228, dt.29.04.2004 `` Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare``)

Periudha kontabël e Pasqyrave Financiare : 01 . 01 . 2017 deri 31 . 12 . 2017

Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare : 04.05.2018

Pasqyrat Financiare janë individuale : Po _____

Pasqyrat Financiare janë të konsoliduara : Jo _____

Pasqyrat Financiare janë të shprehura në : Leke _____

Pasqyrat Financiare janë të rrumbullaksura në : Leke _____



Handwritten signature and blue circular stamp of KID ZONE.

PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT

PASQYRA E FLUKESEVE MONETARE

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE



1. Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Zëri i Bilancit	Shënime	31.12.2017	31.12.2016
A	AKTIVET		726,121,968	572,976,259
I	Aktivet Afatshkurtra		666,273,027	499,572,993
1	Mjete monetare	5	428,847,878	333,563,240
2	Investime :		-	-
a)	<i>Në tituj pronësie të njësjive ekonomike brenda grupit</i>		-	-
b)	<i>Aksionet e veta</i>		-	-
c)	<i>Të tjera financiare</i>		-	-
	Totali		428,847,878	333,563,240
3	Të drejta të arkëtueshme :		50,243,280	11,894,374
a)	<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	6	3,530,803	2,784,015
b)	<i>Nga njësitë ekonomike brenda grupit</i>	6	40,270,190	9,110,359
c)	<i>Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		-	-
d)	<i>Të tjera</i>	7	6,442,287	-
e)	<i>Kapital i nënshkruar i papaguar</i>		-	-
	Totali		50,243,280	11,894,374
4	Inventarët:		186,952,804	154,115,379
a)	<i>Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme</i>		-	-
b)	<i>Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte (Inventar Imet)</i>	8	-	1,014,876
c)	<i>Produkte të gatshme</i>		-	-
d)	<i>Mallra</i>	8	186,952,804	153,100,503
e)	<i>Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)</i>		-	-
f)	<i>AAGJM të mbajtura për shitje</i>		-	-
g)	<i>Parapagime për inventar</i>		-	-
	Totali		186,952,804	154,115,379
5	Shpenzime të shtyra	9	229,065	-
6	Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara		-	-
	I-Aktive totale afatshkurtra		666,273,027	499,572,993
II	Aktive Afatgjata		59,848,941	73,403,266
1	Aktive financiare:		-	-
a)	<i>Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit</i>		-	-
b)	<i>Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit</i>		-	-
c)	<i>Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		-	-
d)	<i>Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		-	-
e)	<i>Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata</i>		-	-
f)	<i>Tituj të tjerë të huadhënies</i>		-	-
	Totali		-	-
2	Aktivitet materiale:		59,848,941	53,195,954
a)	<i>Toka dhe ndërtesa</i>		-	-
b)	<i>Impiante dhe makineri</i>	10	24,379,098	44,231,987
c)	<i>Të tjera Instalime dhe pajisje</i>	10	35,469,843	8,963,967
d)	<i>Parapagime për aktive materiale dhe në proces</i>		-	-
	Totali		59,848,941	53,195,954
3	Aktive Biologjike		-	-
4	Aktive jo materiale:		-	20,207,312
a)	<i>Koncesione, patenta, licenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme</i>	10	-	20,207,312
b)	<i>Emri i Mirë</i>		-	-
c)	<i>Parapagime për AAJM</i>		-	-
	Totali		-	20,207,312
5	Aktive tatimore të shtyra		-	-
	II-Aktive totale afatgjata		59,848,941	73,403,266
	Aktive totale (I+II)		726,121,968	572,976,259

Pasqyrat Financiare të lexohen së bashku me shenimet shpjeguese 1-29 në vijim.

1. Pasqyra e Pozicionit Financiar

Zëri i Bilancit		Shenime	31.12.2017	31.12.2016
B	DETYRIME DHE KAPITALI		726,121,968	572,976,259
I	Detyrimet afatshkurtra		322,748,588	419,537,035
1	Detyrime afatshkurtra:		321,264,444	419,537,035
a)	Titujt e huamarrjes ASH	11	-	108,420,648
b)	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë		-	-
c)	Arkëtimet në avancë për porosi	12	1,265,833	-
d)	Të pagueshme për aktioitetin e shfrytëzimit ASH	13	170,721,468	227,662,311
e)	Dëftesa të pagueshme		-	-
f)	Të pagueshme ndaj njësitve ekonomike brenda grupit	13	38,023,947	65,365,898
g)	Të pagueshme ndaj njësitve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
h)	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	14	1,386,883	1,355,668
i)	Të pagueshme për detyrimet tatimore	15	82,409,105	16,732,510
j)	Të tjera të pagueshme	16	27,457,207	-
	Totali		321,264,444	419,537,035
2	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	17	1,484,144	-
3	Të ardhura të shtyra			
4	Provizione			
	I-Totali i Detyrimeve afatshkurtra		322,748,588	419,537,035
II	Detyrime afatgjata			45,705,475
1	Detyrime afatgjata:			45,705,475
a)	Titujt e huamarrjes	16	-	39,056,039
b)	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë		-	-
c)	Arkëtimet në avancë për porosi		-	-
d)	Të pagueshme për aktioitetin e shfrytëzimit		-	-
e)	Dëftesa të pagueshme		-	-
f)	Të pagueshme ndaj njësitve ekonomike brenda grupit		-	-
g)	Të pagueshme ndaj njësitve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
j)	Të tjera të pagueshme	16	-	6,649,436
	Totali			45,705,475
2	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara			
3	Të ardhura të shtyra			
4	Provizione:			
a)	Provizione për pensionet			
b)	Provizione të tjera			
	Totali			
5	Detyrime tatimore të shtyra			
	II-Totali i Detyrimeve afatgjata			45,705,475
	Detyrime totale(I+II)		322,748,588	465,242,510
III	Kapitali dhe Rezervat		403,373,379	107,733,748
1	Kapitali i Nënshkruar	18	100	100
2	Primi i lidhur me kapitalin			
3	Rezerva rivlerësimi			
4	Rezerva të tjera		107,733,648	36,172,749
a)	Rezerva ligjore			
b)	Rezerva statutore			
c)	Rezerva të tjera	19	107,733,648	36,172,749
5	Fitimi i pashpërndarë			
6	Fitim/ Humbja e Vitit	20	295,639,631	71,560,899
	III-Totali i Kapitalit		403,373,379	107,733,748
	TOTALI DE TYRIMEVE DHE KAPITALIT		726,121,968	572,976,259

Pasqyrat Financiare të lexohen së bashku me shenimet shpjeguese 1-29 në vijim.

2.1. Pasqyra e Performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)

N.r.	P Ë R S H K R I M I	Shenime	në lekë	
			Viti 2017	Viti 2016
1	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	21	1,621,989,372	1,438,513,039
2	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimin në proces		-	-
3	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar		-	-
4	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	22	64,669,506	13,709,979
5	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(1,259,780,059)	(1,286,971,826)
a)	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	23	(1,012,821,674)	(1,058,940,450)
b)	Të tjera shpenzime	24	(246,958,385)	(228,031,376)
6	Shpenzime të personelit		(64,823,664)	(52,815,571)
a)	Paga dhe shpërblime		(56,337,227)	(45,798,175)
b)	Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)		(8,486,437)	(7,017,396)
c)			-	-
7	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
8	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(15,870,091)	(16,904,789)
9	Shpenzime të tjera shfrytëzimi			
10	Të ardhura të tjera	25	7,254,689	448,639
a)	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit financiare		-	-
b)	Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)		-	-
c)	Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)		-	-
d)	Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)		7,254,689	448,639
11	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra		-	-
12	Shpenzime financiare	26	(3,784,056)	(11,790,178)
a)	Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur		(3,769,206)	(6,623,775)
b)	Shpenzime të tjera financiare		(14,850)	(5,166,403)
c)			-	-
13	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		-	-
			-	-
	Fitimi/Humbja para tatimit		349,655,697	84,189,293
			-	-
14	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	27	(54,016,066)	(12,628,394)
a)	Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(54,016,066)	(12,628,394)
b)	Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë		-	-
c)	Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve		-	-
	Fitimi/Humbja e vitit	20	295,639,631	71,560,899
			-	-
	Fitimi/Humbja për:		-	-
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		-	-
	Interesat jo-kontrolluese		-	-

2.2.Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

N.r.	P Ë R S H K R I M I	Shënime	në lekë	
			Viti 2017	Viti 2016
1	Fitimi/Humbja e vitit		295,639,631	71,560,899
2	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
a)	Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		-	-
b)	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
c	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktivet financiare të mbajtura për shitje		-	-
d	Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet		-	-
	Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
3	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
4	Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:		295,639,631	71,560,899.00
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		295,639,631	71,560,899.00
	Interesat jo-kontrolluese		-	-

4. Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto për vitin 2017

P E R S H K R I M I	Kapitali i nënshtuar	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërdara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali	në lekë	
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2016	100	36,172,749	0	78,576,941	114,749,790	0	114,749,790		
Te ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:				0	0		0		
Fitimi / Humbja e vitit				71,560,899	71,560,899		71,560,899		71,560,899
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:					0		0		0
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:					0		0		0
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:					0		0		0
Emetimi i kapitalit të nënshtuar					0		0		0
Dividende të paguar				-78,576,941	-78,576,941		-78,576,941		-78,576,941
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike					0		0		0
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2016	100	36,172,749	0	71,560,899	107,733,748	0	107,733,748		107,733,748
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2017	100	36,172,749	0	71,560,899	107,733,748	0	107,733,748		107,733,748
Te ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					0		0		0
Fitimi / Humbja e vitit				295,639,631	295,639,631		295,639,631		295,639,631
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:					0		0		0
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:					0		0		0
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:					0		0		0
Brija e rezervave nga fitimi i vitit 2016		71,560,899		-71,560,899	0		0		0
Dividende të paguar					0		0		0
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike					0		0		0
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2017	100	107,733,648	0	295,639,631	403,373,379	0	403,373,379		403,373,379
					0		0		0

3. Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare

N.r.	P Ë R S H K R I M I	Shenime	Viti 2017	Viti 2016
A	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit			
1	Të arkëtuara nga të drejtat e arkëtueshme		1,953,486,733	1,735,450,109
2	Të paguara për detyrimet e pagueshme dhe detyrimet ndaj punonjësve		(1,873,532,784)	(1,433,949,321)
3	Pagesa të tjera			
4				
	Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti i shfrytëzimit		79,953,949	301,500,788
5	Interesi i paguar - Interest paid		(3,769,206)	(6,623,775)
6	Tatim fitimi i paguar - Taxtion paid		(13,995,791)	(12,334,860)
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		62,188,952	282,542,153
B	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
1	Para neto të përdorura për blerjen e filialeve		-	-
2	Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve		-	-
3	Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(2,315,764)	(1,985,393)
4	Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		-	-
5	Pagesa për blerjen e investimeve të tjera			
6	Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera			
7	Dividentë të arkëtuara - Dividends received			
8				
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(2,315,764)	(1,985,393)
C	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
1	Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		-	-
2	Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral		-	-
3	Hua të arkëtuara (neto)		34,621,309	51,937,980
4	Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe			
5	Riblerje e aksioneve të veta			
6	Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral		-	-
7	Pagesa e huave (neto)			
8	Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare			
9	Interesi i paguar - Interest paid			
10	Dividendë të paguar - Dividends paid		-	(78,576,941)
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		34,621,309	(26,638,961)
	Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		94,494,497	253,917,799
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fillim te periudhes kontabel		333,563,240	79,645,441
8	Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		790,141	
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fund te periudhes kontabel	9	428,847,878	333,563,240

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Ortakëve të shoqërisë "Kid Zone" sh.p.k.

Autostrada Tirane -Durres km 0,Mbikalimi i Kamzes, Terminali Center,
Tiranë

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare "Kid Zone" shpk, me NIPT L11716007K të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2017, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar, si dhe parimet bazë e rregullat e parashikuara në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit në vijim, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare.

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi i shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen, janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të bazuara në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave përkatëse të shoqërisë, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha mbi aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me Drejtimin, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm, që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Venis-Audit & Finance sh.p.k.

Vera Lala
Administrator



Tiranë, më 28 Qershor 2018

Vera Lala
Auditues Ligjor

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

1. INFORMACIONE TE PERGJITHESHME

Shoqëria " KID ZONE " sh.p.k. me NUIS - L11716007K, është krijuar me date 12 Maj 2011 dhe regjistruar ne regjistrin e shoqërive tregtare me 16 Maj 2011, me kapital te nënshkruar prej 100 leke.

Ortake te saj jane: Shoqëria " BALFIN " shpk, e cila zoteron 90% te kapitalit dhe z.Julian Mane i cili zoteron 10% te kapitalit.

Administrator i shoqërise eshte z. Toljan Papajorgji, me afat emerimi deri me 29.05.2023.

Objekti i veprimtarisë Shoqërisë është: Import-eksport, shitja me shumice dha pakice e produkteve tekstile, veshjeve te te gjitha llojeve, etj, sikurse eshte percaktuar ne statut.

Selia e shoqërise ndodhet ne adresen: Autostrada Tirane -Dures km 0, Mbikalimi i Kamzes, Terminali Center, Tirane. Shoqëria e ushtron aktivitetin tregtar ne adresat sekondare qe ndodhen ne QTU, TEG, Mbrostar-FIER, Shkoder dhe rruga Gryka e Kaçanikut, Godina e Parkut Logjistik.

2. BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE

Shoqëria i mban te dhënat e kontabilitetit dhe publikon pasqyrat e saj financiare të vitit 2017 në bazë të Standardeve Kombëtare të Raportimit Financiar ("SKK"), të shpallura me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 4292 datë 15.06.2006 dhe në përputhje me Ligjin mbi kontabilitetin no: 9228 datë 29 Prill 2004 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike. Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar ("Lekë"), e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik, ku operon Shoqëria. Shifrat janë të rrumbullakosura në Lekë.

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare janë të kompensuara dhe shumat neto raportohen në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ka të drejtë ligjore për t'i kompensuar shumat e njohura dhe ka një përpjekje për t'i vendosur në bazë neto, ose për realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë të kompensuara në pasqyrën e te ardhurave gjithpërfshirëse pasi nuk kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard i kontabilitetit ose interpretim, dhe ndonjë politikë kontabël e Shoqërisë.

Parimi i vijimësisë

Drejtimi i shoqërisë ka kryer një vlerësim të aftësisë së shoqërisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe është i kënaqur që shoqëria ka burime për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu, drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.

3. GJYKIMET, VLERESIMET DHE SUPOZIMET KONTABEL TE RENDESISHME

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRFkërkon që Drejtimi të bëjë disa gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi kryhet dhe në ndonjë periudhë të ardhshme, në të cilën ato ndikojnë. Informacioni mbi elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë paraqitur më poshtë.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Nuk ose ka politika të rëndësishme kontabël të adoptura nga Shoqëria të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime të informacioneve shpjeguese të bazuara në metodat e mëposhtme. Kur janë të aplikueshme, informacione rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë paraqiten në shënimet specifike të aktiveve ose detyrimeve.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatim fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurtë. Shoqëria njeht detyrimet për çështjet e parashikuara tatimore të auditimit bazuar në vlerësimin nëse do të ketë shtesa në taksë. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumatat të cilat kanë qenë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në tatim fitimin aktual dhe të shtyrë dhe detyrimet në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë

4. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Rregjistrimet kontabël të njësisë janë të përgatitura në Lekë Shqiptar, e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon shoqëria.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) rregjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit që është kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2017, 1 Euro me 132.95 Lekë (nga 135.23 LEK/Eur ne 31.12.2016) dhe 1 USD me 111.1 Lekë (nga 128.17 LEK/Eur ne 31.12.2016)

Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë që janë të regjistruara në monedhë të huaj, rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat nga këmbimi njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse si fitim apo humbje në periudhën në të cilën ata ndodhin përveç diferencave të këmbimeve për huamarrjet në monedhë të huaj të lidhura me aktivet në ndërtim për përdorim të ardhshëm, të cilat përfshihen në kostot e atyre aktiveve kur ato lidhen me një rregullim në koston e interesit të huamarrjeve në monedhë të huaj.

(b) Instrumentat financiare

Shoqëria fillimisht i ka njohur llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën e krijimit të tyre. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë edhe aktivet e vlerësuar me vlerën e drejtë) njihen në datën e tregtimit, datën kur shoqëria ka lidhur një kontratë për këto instrumenta. Shoqëria ç' rregjistron një aktiv financiar në momentin kur të drejtat kontraktuale për flukset nga këto aktive skadojnë, ose transferon të gjitha të drejtat për të përfituar flukset kontraktuale të të ardhurave të aktivitetit financiar me anë të një transaksioni, i cili transferon përfitimet dhe rreziqet që lidhen me pronësinë e aktivitetit. Ndonjë interes që është mbajtur apo krijuar mbi aktivet e transferuara nga shoqëria paraqitet më vete si një e drejtë apo detyrim. Detyrimet dhe të drejtat financiare kompesohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë këto në vlerë neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Instrumentat financiar jo derivativë të shoqërisë përfshijnë të drejta të tregtueshme dhe të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, detyrime të tregtueshme dhe të tjera

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare, si dhe depozitat afatshkurtra me një maturitet tre mujor ose me pak. Për qëllime të pasqyres së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përbehen nga paraja dhe depozitat afatshkurtra të percaktuara me lart, pasi i zbritet teprica e paradhëniesve bankare.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi

Huamarrjet dhe parapagimet

Huatë e marra nga Institucionet Financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv.

Metoda e normës efektive të interesit është një metodë për llogaritjen e koston së amortizuar të një detyrimi financiar dhe për alokimin e shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skanton ekzakhtësisht pagesat e ardhshme të vlerësuara përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër..

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit

Te tjera

Instrumenta të tjera financiare jo derivative janë matur me koston e amortizueshme, duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet. *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

(c) Aktivet Afatgjata investimi

Aktive afatgjata investimi, të cilat janë prona të mbajtura për të fituar të ardhura nga qerata dhe / ose për rivlerësimin e kapitalit (duke përfshirë prona në ndërtim për qëllime të tilla), maten fillimisht me kosto, duke përfshirë koston e transaksionit. Ato njihen fillimisht në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin që rreziqet dhe përfitimet nga pronësia transferohen te shoqëria pavarësisht nga fakti nëse titulli është transferuar apo jo. Ato maten fillimisht me koston. Pas momentit të njohjes, në vijim aktivet afatgjata investimi maten me modelin e koston. Aktivet afatgjata investimi, të cilat janë në proces ndërtimi të lidhura me projekte të reja me të cilat po merrët shoqëria, për ndërtimin e magazinave që do të jepen me qera ku përfshirja e shoqërisë në menaxhimin do të jetë minimale. Si e tillë, shoqëria po llogarit kostot direkte të ndodhura gjatë procesit të ndërtimit dhe sjelljes së aktivitetit në kushtet për të dhënë me qera.

(d) Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe kosto të tjera që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë për sjelljen e aktivitetit në gjëndje pune për qëllimin që i është caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktiveve dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjëndjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat të tjera përmbledhëse për fitime apo humbje të kualifikimit të flukseve të

parasë të mbuluara nga blerjet në monëdhë të huaj të aktiveve aftagjata materiale. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje. Në momentin që një nga aktivet aftagjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato rregjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve aftagjata materiale percaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitetit aftagjatë material dhe njihen neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Kostot ne vijim

Kostot për zëvendësimin e një pjese të aktivitetit aftagjatë material rregjistrohen me vlerën kontabël të aktivitetit në rast së është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera e kontabël e pjesëve të ndërruara si rrjedhojë ç'rregjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve rregjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme e cila është kostoja e aktivitetit ose çdo kosto tjetër zëvendësuese minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet ne pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse bazuar në metodën e vlerës së mbetur sipas normave të mëposhtme për secilën kategori asetesh:

- | | |
|------------------------|-----|
| a) Ndërtesa | 5% |
| b) Makineri e Pajisje | 20% |
| c) Mjete transporti | 20% |
| d) Pajisje informatike | 25% |

Kjo mënyrë pasqyron më përfaqësisht trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive. Aktivitetet në proces nuk amortizohen. Nëse normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura, nuk janë të parëndësishme, aktiveve aftagjata materiale rivlerësohen në datën e raportimit.

(e) Aktive aftagjata jomateriale

Njohja dhe matja

Aktivitetet jomateriale të blera nga shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe rënie në vlerë të akumuluar.

Kostot ne vijim

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktiviteti specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mirë dhe markës, njihen në pasqyrën e të ardhurave përmblëdhëse (në humbje ose fitime) në momentin e ndodhjes.

(f) Zhvlerësimi

Aktivitetet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në rënie të vlerës së tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitetit, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në vlerësimin e flukseve të ardhshme nga aktiviteti të cilat mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga rënia në vlerë e aktivitetit të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave përmblëdhëse (në humbje ose fitim) në një llogari zbritje kundër të arkëtueshmet. Interesi nga aktivitetet e

zhvlerësuara në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shumat përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave, fitimit ose humbjeve.

Aktivet jo financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidence e tillë atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuara skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqeve specifike të aktiveve që nuk janë marrë parasysh në vlerësimin e flukseve të ardhshme. Humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit ose e njësive të tij të gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

(g) Perfitimet e punonjesve

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Gjatë ecures normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjesve për kontributet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacion. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin e ndodhjes.

Pensioni i detyrueshëm

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj, bën pagesa në emër të saj dhe në emër të punonjesve për të kontribuar në planin e pensionit sipas legjislacionit lokal. Kostot që ndodhin për këto plane i takojnë shoqërisë dhe ngarkohen në fitimin ose humbjen brenda vitit ushtrimor.

Leja e zakonshme e paguar

Shoqëria njih si detyrim shumat e paskontuara të kostove të lidhura me lejen vjetore e cila pritët të paguhet në shkëmbim të shërbimit të ofruar nga punonjësi për periudhën.

(h) Provigjonet

Provigjoni njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

(i) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecures normale të aktivitetit të biznesit.

(j) Të ardhurat nga qerata

Të ardhurat nga qeraja janë të ardhura të përfituara nga kontratat e qerasë, përveç të ardhurave të kushtëzuara të qerasë të cilat njihen kur përfitohen. Kostot fillestare direkte që ndodhin gjatë negociimit të një kontrate qeraje njihen si shpenzime në termat e qerasë me të njëjtat baza sit ë ardhurat nga qeraja.

Përpjekjet për të nënshkruar një kontratë qeraje janë shpërndarë në mënyrë të barabartë përgjatë aftatit të kontratës së qerasë edhe nëse këto pagesa nuk bëhen në këto baza. Afati i qerasë është një periudhë e

pa anulleshme qeraje së bashku me afate të tjera të mëtejshme për të cilat qeramarrësi ka opsionin për të vazhduar qeranë, kur, në fillim të qerasë drejtimi ka një siguri të arsyeshme që qeramarrësi do ta ushtrojë këtë opsion.

Shumat e marra nga qeramarrësi për përfundimin e qerasë ose kompesimin e përfundimit të saj njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse kur lind e drejta për ti marrë ato..

(k) Pagesat per qeranë financiare

Qeratë klasifikohen si qera financiare kur kushtet e qerasë transferojnë në menyrë domethënëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë tek qeramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera klasifikohen si qera operative. Pagesat e bëra për qeranë operative janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës

Depozitimet e qeramarrësit

Detyrimet e depozitimeve të qeramarrësit fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe maten më kosto të amortizueshme kur është materiale. Diferencat ndërmjet vlerës fillestare të drejtë dhe shumës nominale përfshihet si një komponent i të ardhurave nga kontrata e qerasë dhe njihen në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.

(l) Te ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga kursi i këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

(m) Kostot e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati për qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interesi, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet kostos së aktivitetit.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

(n) Taksat

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zera të njohur direkt në kapital, në të cilat regjistrohen direkt në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm, i pagueshëm mbi fitimin e tatueshem për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke paraqitur për diferencat e përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit

Një aktiv i tatimit të shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhurat e ardhshme të tatueshme do të realizohen kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme që përfitimet tatimore të lidhura me të do të realizohen.

(o) Ngjarjet pas datës së bilancit

Ngjarjet pas datës së raportimit, të cilat ofrojnë dëshmi për kushtet që ekzistojnë në datën e raportimit, trajtohen si ngjarje të korrigjueshme në këto pasqyra financiare. Ata që janë tregues të kushteve që lindin pas datës së raportimit janë trajtuar si ngjarje të pakorrigjueshme.

Shënime për zërat (elementet) e pasqyrave financiare.

5.Mjete monetare

Në këtë zë përfshihen mjetet monetare gjendje në datë 31.12.2017, në llogaritë rrjedhëse pranë bankave të nivelit të dytë si dhe në arkë. Për njohjen fillestare të këtyre elementeve si dhe për gjendjet, është përdorur politika kontabël e “vlerës së drejtë”.

Likuiditete dhe vlera arke te tjera	31.12.2017	31.12.2016
Llogari ne banke	398,825,128	322,710,450
Llogari rrjedhese ne LEK	368,782,852	72,283,443
Llogari rrjedhese ne monedhe te huaj	30,042,275	250,427,007
Para ne dore	30,022,750	10,852,790
Ne monedhe vendase	30,022,750	10,852,790
Ne monedhe te huaj	0	0
Total mjete monetare	428,847,878	333,563,240

6. Të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit

Emertimi	31.12.2017	31.12.2016
Kliente	3,530,803	2,784,015
Kliente, kompanite e grupit BALFIN	40,270,190	9,110,359
TOTAL	43,800,993	11,894,374

Në këtë zë janë përfshirë “kërkesa të arkëtueshme” nga klientët, “Kostoja e amortizuar” është metoda e përdorur për vlerësimin e tyre.

7. Të drejta të tjera

Emertimi	31.12.2017	31.12.2016
Dogana shqiptare	245,685	0
Parapagim furnitoresh (sherbime)	1,007,541	0
POS ne Pritje (shitje dt 30-31.12.17)	5,189,061	0
TOTAL	6,442,287	0

8.Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme

Emertimi	31.12.2017	31.12.2016
Inventar i imet	0	1,014,886
Mallra per shitje	186,952,804	153,100,503
TOTAL	186,952,804	154,115,389

Në këtë zë janë përfshirë gjendjet e inventarit të "Inventarit të imët", të cilat përdoren për nevoja të shoqërisë, dhe inventarit të mallrave për rishitje.

9. Shpenzime të shtyra

Emertimi	31.12.2017	31.12.2016
Etiketa per mallrat	229,065	0
TOTAL	229,065	0

10. Aktivët afatgjatë materiale (AAM) dhe jo-materiale (AAJM)

Emertimi	Makineri, Pajisje dhe Instalime	Mobilje dhe pajisje zyre	Te tjete aktive afatgjatë materiale	AAJM	Totali
Kostoja					
31.12.2016	105,341,379	15,886,865	0	46,986,753	168,214,997
Riklasifikim			46,986,753	-46,986,753	0
Shtesa	1,623,669	232,745	459,351		2,315,764
Pakesime					0
31.12.2017	106,965,048	16,119,610	47,446,104	0	170,530,761
Amortizimi Akumuluar					
31.12.2016	(59,317,478)	(8,714,811)	0	(26,779,441)	(94,811,730)
Riklasifikim			(26,779,441)	26,779,441	0
Shtesa	(9,928,875)	(1,467,542)	(4,473,674)		(15,870,091)
Pakesime					0
31.12.2017	(69,246,353)	(10,182,353)	(31,253,115)	0	(110,681,821)
Vlera Neto					
31.12.2016	46,023,901	7,172,054	0	20,207,312	73,403,266
31.12.2017	37,718,695	5,937,257	16,192,989	0	59,848,941

Në pasqyrën e pozicionit financiar AAM-te paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Vlerat e mësipërme të AAM-ve, përputhen me inventarin fizik të tyre datë 31.12.2017

Ne vitin 2016 ne postin "Koncesione, patenta, liçenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme" ishte pasqyruar vlera neto prej 20,207,312 Leke, e cila u riklasifikua si aktiv Afatgjate Material ne vitin 2017,duke u paraqitur ne grupin "Te tjeta aktive afatgjata materiale".

11. Detyrime ndaj institucioneve të kredisë

Emertimi	31.12.2017	31.12.2016
Hua e marre nga NBG	0	108,420,648
TOTAL	0	108,420,648

Ne këtë llogari janë paraqitur detyrimet e shoqërisë për Huatë afatshkurtra te mbartura nga viti 2016, te paguara gjate vitit 2017.

12. Arketime ne avanc per porosi

Emertimi	31.12.2017	31.12.2016
Parapagime te arketuara per leshim kuponash	1,265,833	0
TOTAL	1,265,833	0

13. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Emertimi	31.12.2017	31.12.2016
Furnitore per mallra e sherbime	170,721,468	227,662,311
Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit	38,023,947	65,365,898
TOTAL	208,745,415	293,028,209

Në këtë grup janë përfshirë detyrimet e pagueshme ndaj furnitorëve. Në njohjen fillestare zërat e këtij grupi janë vlerësuar me kosto. Në vijim të njohjes fillestare, huatë dhe detyrimet e tjera paraqiten me kosto të amortizueshme duke njohur çdo diferencë midis koston dhe vlerës së rekuperueshme në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huamarrjes në bazë të një interesi efektiv.

14. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve

	31.12.2017	31.12.2016
Paga	2,095	258,279
Sigurime Shoqerore dhe te Ngjashme	1,384,788	1,097,390
TOTAL	1,386,883	1,355,668

Në llogaritjen e detyrimeve tatimore shoqëria ka mbajtur parasysh kërkesat e Ligjit "Për Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore", për mardheniet e punes.

15. Të pagueshme për detyrimet tatimore

Emertimi	31.12.2017	31.12.2016
Detyrim për Tatim Fitimi	40,313,809	293,534
Detyrim për Tatim mbi paga	312,671	200,215
Detyrim për TVSh	40,538,905	22,187,462
Detyrim për tatim në burim	1,243,720	0
Dogana	0	-5,948,701
TOTAL	82,409,105	16,732,510

Në llogaritjen e detyrimeve tatimore shoqëria ka mbajtur parasysh kërkesat e Ligjit "Për TVSH-në", për "Tatimin mbi të ardhurat" etj, të zbatueshme për aktivitetin e shoqërisë tonë.

16. Të tjera të pagueshme

Emertimi	31.12.2017	31.12.2016
Hua nga ortakut	20,737,771	0
Divident	6,649,436	0
Hua të tjera (pale e lidhur)	70,000	0
TOTAL	27,457,207	0

Ne këto post janë paraqitur gjendja e huave të pagueshme në vitin 2018. Në vitin 2016, huatë dhe dividendet ishin klasifikuar si detyrime afatgjata të shoqërisë.

17. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Emertimi	31.12.2017	31.12.2016
TEG (Dhjetor 2017)	1,057,468	0
UKT(Dhjetor 2015)	1,676	0
Kupona (Dhjetor 2017)	425,000	0
TOTAL	1,484,144	0

18. Kapitali

Emertimi	31.12.2017	31.12.2016
Shoqëria "BALFIN" shpk (90%)	90	90
Juljan Mane (10%)	10	10
TOTAL	100	100

Kapitali i regjistruar i shoqërisë i paraqitur në bilanc, është i njëjtë me atë të përcaktuar në statutin e shoqërisë dhe me vendimet e depozituara në QKR.

19.Rezerva të tjera

Shoqëria ka krijuar rezerva në përputhje me vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme. Kështu me vendimin nr.33, date 29.06.2017, fitimi i vitit 2016 me vlerë 71,560,899 Leke, është caktuar për të rritur Rezervat, vlera e të cilave me date 31.12.2017 ishte 107,733,648 Leke (31.12.2016: 36,172,749 Leke).

20.Fitimi i vitit

Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
Total te ardhura	1,693,913,567	1,452,993,488
Total shpenzime	-1,398,273,936	-1,381,432,589
FITIMI TOTAL	295,639,631	71,560,899

Rezultati Financiar i vitit 2017 ishte Fitim, me vlerë 295,639,631 Leke, i cili krahasuar me vitin e kaluar ka patur një rritje të rëndësishme, e cila ka ardhur teresisht nga rritja e volumit të shitjeve.

21. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

	Viti 2017	Viti 2016
Shitje Mallrash TVSH 0	6,083,963	0
Shitje Mallra TEG	1,037,077,825	900,649,199
Shitje Mallra QTU	578,827,584	537,863,840
TOTAL	1,621,989,372	1,438,513,039

Të ardhurat nga shitja janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve të ofruara, të zhveshura nga TVSH-ja. Paraqitja në pasqyrat financiare e të ardhurave e shpenzimeve është bërë sipas natyrës së tyre.

22. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

	Viti 2017	Viti 2016
Shitje e punimeve dhe e shërbimeve	49,932,142	0
Te ardhura, shitje shërbime Kosove	7,752,859	0
Eksport 3 Tranzit	6,984,505	13,709,979
TOTAL	64,669,506	13,709,979

23. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

	Viti 2017	Viti 2016
Kosto e mallrave të shitura	-946,483,461	-998,748,871
Pagesa për marken tregtare	-66,338,213	-60,191,579
TOTAL	-1,012,821,674	-1,058,940,450

24. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
Bl.energji,avull,uje	-4,003,295	-13,390,474
Qira	-132,541,336	-116,294,958
Mirembajtje dhe riparime	-4,922,688	-2,835,762
Sigurime	-561,066	-572,009
Te tjera	-3,823,740	-8,697,839
Sherbime pastrimi etj.	-36,069,007	-39,664,243
Personel nga jashtë ndërmarrjes	-22,331,315	-15,261,964
Publicitet, reklama	-9,376,326	-11,538,956
Transferime, udhëtim, diëta	-6,418,806	-11,104,334
Shp.z.postare e telekom.	-1,467,583	-404,639
Transporte për shitje	-4,293	0
Për personelin	-143,380	0
Sherbime bankare (Komisioni garancis 3/m)	-4,855,891	-3,788,496
Taksa dhe tarifa vendore	-788,500	-408,572
Tatime të tjera	-21,792	-501,904
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	-5,670,381	-369,748
Gjoha etj shp.panjohura	-10,451,411	0
Shpenzime të tjera	-3,507,576	-3,197,478
TOTAL	-246,958,385	-228,031,376

Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit për 246,958,385 Leke . Shpenzimet janë njohur mbi bazën e të drejtave të konstatuara.

25. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme

	Viti 2017	Viti 2016
Te ardhura nga interesat	603,244	0
Te ardhura nga veprimet në monedhe të huaj	6,651,445	448,639
TOTAL	7,254,689	448,639

26. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme

	<u>Viti 2017</u>	<u>Viti 2016</u>
Shpenzime per interesa	-3,769,206	-6,623,775
Humbje nga veprimet ne monedhe te huaj	-14,850	-5,488,234
Te tjera	0	321,831
TOTAL	-3,784,056	-11,790,178

Shpenzimet e interesave vijnë kryesisht nga përdorimi i kredisë bankare , overdraftit dhe garancive bankare te lidhura me aktivitetin.

Shpenzimet e tjera financiare vijnë si pasoje e kursit te këmbimit dhe transaksioneve ne monedha te huaja.

27. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

	<u>Viti 2017</u>	<u>Viti 2016</u>
Fitimi para tatimit	349,655,697	84,189,293
Shpenzime te pazbritshme	10,451,411	0
Fitimi tatimor i ushtrimit/ Humbje	360,107,108	84,189,293
Humbje te mbartura	0	0
Fitimi i tatueshem i ushtrimit	360,107,108	84,189,293
Norma e tatimit	15%	15%
Tatim fitimi	-54,016,066	-12,628,394
Fitimi neto/Humbja	295,639,631	71,560,899

Shpenzimi i tatim fitimit i llogaritur për vitin ushtrimor 2017 bazohet në detyrimin për tatim fitimin sipas Legjislacionin Fiskal në Shqipëri. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15%. Niveli taksimit per fitimin zbatuar në vitin paraardhës 2016 ka qënë 15%.

28. Palet e lidhura

Shoqëria ka realizuar marrëdhënie me palë të lidhura me shoqërinë mëmë (Balfin sh.p.k) dhe kompanitë e grupit . Një numër transaksionesh janë kryer me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Këto transaksione janë kryer në terma tregtare dhe në normat e tregut.

29. Ngjarje pas dates se bilancit

Pas datës së bilancit kontabël nuk kanë ndodhur ngjarje që te ndikojne në rezultatin financiar të vitit ushtrimor te mbyllur me 31.12.2017.

Tirane me 04 Maj 2018

SHOQERIA " KID ZONE "
NIPTI L 11716007 K

Datë, 04/05/2018

DEKLARATE

Shoqëria KID ZONE me NIPT L 11905002 N me administrator Z. Toljan Papajorgji dhe ortak te shoqërisë:

1. Shoqëria "BALFIN" sh.p.k. përqindja e pjesëmarrjes 90 %
2. Z. Julian MANE përqindja e pjesëmarrjes 10 %

Ka hartuar pasqyrat financiare të vitit 2017 sipas standardeve kombëtare te kontabilitetit.

Hartuesi i pasqyrave financiare është: Z. JORGJI ZALLËMI Kontabël i Miratuar

Administratori i Shoqërisë
Toljan Papajorgji

